



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:243249

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06097830

P.nr.380/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE – DEGA NE VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit D.D. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1895/20 të dt.28.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 05.08.2024, në praninë e të pandehurit D.D., dhe prokurores se shtetit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën: 28.08.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: D.D., nga i ati N..., dhe e ëma F..., e vajzeris M..., lindur me ... ne Mitrovicë, ku edhe jeton ne rrugën "... " nr. ... Mitrovicë, ka te kryer shkollën fillore, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

SEPSE: Me datë 31.08.2020, rreth orës 09:00 në parkingun e "...", i cili gjendet afër magjistrales në dalje të Vushtrrisë në drejtim të Prishtinës, i pandehuri me dashje dhe me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, i merr pasurin e personit tjetër dhe atë veglat muzikore ashtu qe derisa B.M. kishte sjell disa vegla muzikore nga Suedia dhe i kishte vendosur ne vendin e lartcekur, pasi qe vetura nuk i kishte zënë te gjitha veglat ne automjetin e tij, një pjese te tyre i kishte lënë aty qe te kthehet pas disa minutave qe ti marr atëherë i pandehuri e ka shfrytëzuar rastin dhe i ka marr disa nga ato vegla muzikore,

Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-se (Kodi nr.06/L-074).

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 38, 21, 42, 43, 69, 70, dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 364, 449, 452, e 462 të KPP-së:

G J Y K O N

Tw pandehurit D.D. i shqipton dënim me gjobë në shumën prej **300€ (treqind euro)** i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Po ashtu kumulativisht gjykata i shqipton:

Dënimin me burg ne kohëzgjatje prej **pesë (5) muaj** i cili dënim do te ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **30€ (tridhjetë) euro**, në emër te shpenzimeve te transportit te paguaj shumen prej 120€ (njëqindnjëzet euro) në emër të taksës për kompensimin e fondit për viktimat e krimit të paguaj shumën prej **20€ (njëzetë) euro**.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e arsyetimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore ne Mitrovice - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1895/20 të dt.28.102021, kundër te pandehurit D.D., për veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 12.02.2024, në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin të pandehurit pasi është informuar lidhur me të drejtat e tij dhe i ka kuptuar ato, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë ku i pandehuri, ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës, andaj edhe gjykata e ka njoftuar me të drejtën e tij që sipas dispozitave të nenit 243 e 244 KPPRK-së, të paraqes kundërshtimin e provave dhe kërkesë për hudhje te aktakuzës.

I pandehuri ne afatin ligjor nuk ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe as kërkesë për hudhje te aktakuzës, andaj gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor te dt.23.04.2024.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar disa shqyrtime gjyqësore ku ne shumicën e rasteve ka munguar i dëmtuari, dhe dëshmitarët e propozuar dhe përfundimisht seanca e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur me datë 23.04.2024, në të cilat shqyrtime kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, dhe

i pandehuri D.D., ku të pandehurit edhe njëherë pas informimit nga gjykata për të drejtat e tij i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij është deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor te dt. 23.04.2024 prokurori i shtetit ka paraqitur fjalën hyrëse dhe ka deklaruar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, do të vërtetohet nga provat të cilat prokuroria i ka propozuar në kallëzimin penal dhe atë Raporti i policit i datës 31.08.2020, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit F.S. i datës 21.10.2020, dëshmitarit B.M., dëshmitarit A.G., vërtetimi për sekuestrim dhe kthim të sendeve, foto dokumentacioni, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit, këto janë prova që pa dyshim e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale siç është cekur në dispozitiv të aktakuzës. Gjykatës i propozojmë që përveç dëshmitarit të propozuar, të thirren në cilësi të dëshmitarit edhe F.S. dhe A.G..

I pandehuri në fjalën hyrëse ka deklaruar se jam plotësisht i pafajshëm dhe dua që drejtësia të vihet në vend sepse kam qenë i kërcënuar nga B.V., i cili jeton në ..., rr. "...” Mitrovicë ka ardh në shtëpinë time dhe më ka thënë se duhet të shkojë në stacionin policor në Vushtrri që të them kinse e kam kryer një veprën penale të cilën nuk e kam bërë dhe nuk e njoh as pronarin e veturës as sendet të cilat janë cekur, dhe nuk i kam marrë, po ashtu e di kush e ka kryer veprën penale, andaj ju lutem që ti sillni para drejtësisë dhe drejtësia te del në vend. Propozojë që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet B.V., pasi që unë kam qenë i kërcënuar që të shkoj në stacion dhe ta pranojë se unë i kam marrë ato gjësende. E pranojë se kam bërë gabim që kam shkuar dhe i kam kthyer gjësendet për shkak se kam qenë i detyruar nga B.V..

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se pas këtij shqyrtimit gjyqësor nga administrimi i provave materiale dhe personale, dhe atë nga procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit B.M. i datës 21.10.2020, si dhe nga dëshmia e tij dhënë pranë kësaj gjykate me datë 21.05.2024, vërtetohet se me datë 31.08.2020, kishte dalur për ti pranuar disa gjëra të cilat i dëmtuari F.S. ia kishte dërguar, përkatësisht disa vegla muzikore, të sjella nga Suedia dhe është vërtetuar se ka pasur për ti bartur nga parkingu i ... deri në shtëpinë e tij, por që nuk ka mundur ti merrte të gjitha për një herë dhe i është dashur ti bartë pjesë pjesë, dhe pasi që një pjesë e tyre kishin mbetur aty, këtu i pandehuri i kishte marrë në mënyrë të kundërligjshme nga vendi ku i kishte lënë B.M.. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit F.S. dhënë në polici me datë 21.10.2020, nga e cila vërtetohet se e kishte angazhuar B.M. që veglat muzikore të cilat i kishte dërguar nga Suedia, ti merr dhe ti dërgojë në shtëpinë e tij, por që një pjesë nga to ishin vjedhur, por më pas ishin kthyer nga ana e Policisë së Kosovës, dhe atë 70% e tyre, siç edhe është cekur në deklaratë, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit A.G., vërtetohet fakti se automjetin Tauran ngjyrë hiri me targa ..., e kishte marrë nga një person i panjohur në Rent a Car, pra me qera, por që më pas këtë automjet ia kishte dhënë në shfrytëzim D.D., këtu të akuzuarit, me arsyetimin se të njëjtit i është dashur që të shkojë deri në Mitrovicë, dhe atë me datë 30.08.2020, është vërtetuar se ja ka dhënë pasdite dhe me datë 02.09.2020 i njëjti ia kishte kthyer, po ashtu nga dëshmia e tij është vërtetuar se D.D. i kishte vjedhur këto vegla muzikore, pasi që kur policia e kanë thirrë dëshmitarit për deklaratë në polici, i njëjti i kishte thënë mos është fjala për disa vegla muzikore, konkretisht ka thënë mos është fjala për zmadhues zëri, sepse i akuzuari këtu, ia kishte përmendur

A.G. se i kishte gjetur disa vegla muzikore, e që dëshmia e këtij dëshmitari është në lidhshmëri të plotë me deklarimin e të pandehurit dhënë pranë policisë, ku nga e njëjta deklaratë përshkruhet se si gjatë kohës sa ka qenë në Vushtrri, në parkingun e ..., me veturën Tauran, me targa të regjistrimit ... i ka parë disa sende – vegla të muzikës në afërsi të autolarjes dhe e kishte ndalë automjetin dhe i ka ngarkuar në të për ti dërguar në Mitrovicë, po ashtu nga deklaratat e të njëjtit konfirmohet fakti se një ditë më herët e kishte marrë automjetin nga dëshmuari A.G., po ashtu nga deklaratat e tij vërtetohet fakti se si A.G. e kishte lajmëruar të akuzuarin se e kishte njoftuar policia lidhur me marrjen e sendeve të lartëcekura dhe ndër të tjera i akuzuari ka cekur edhe arsyen ku kanë shkuar në polici dhe i kanë ngarkuar veglat muzikore në një taksi dhe i kanë dorëzuar në polici. Ndërsa deklarimit të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, propozojë që gjykata të mos ia falë besimin, pasi i njëjti ka për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale, pasi i nijeti ka deklaruar se A.G. nuk e njeh e që rezulton të jetë e kundërta e saj. po ashtu nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.09.2020, vërtetohen veglat muzikore të sekuestruara si zmadhues zëri, miksete më ngjyrë të zezë i firmës Neba Carls Bro, miksete e madhe ngjyrë hiri M2600, miksete e zezë e firmës RosPC 8400, Kufer më ngjyrë ari i firmës Visa Delsy, dy zmadhues të firmës JD Systems, një torbë me adaptera dhe kablllo të pajisjeve përcjellëse, të gjitha këto vegla muzikore, këto pajisje është vërtetuar se i ka kthyer i akuzuari, po ashtu nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës shihen pajisjet të cilat janë kthyer nga ana e të akuzuarit, andaj pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha këtyre provave prokurori i shtetit vlerëson se përtej dyshimit të bazuar mirë në veprimet e të akuzuarit D.D. formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, për çka prokurori i shtetit gjykatës i propozon që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ashtu që gjatë matjes së dënimit, llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që si rrethane lehtësuese ta merr parasysh faktin e kthimit të pajisjeve të cilat ceken në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve, faktin se vullnetarisht i ka kthyer pajisjet në polici, ndërsa si rrethana rënduese të merr parasysh shkallën e lartë të dashjes, po ashtu gjykatës i propozojë që zyrtarisht të kërkojë nga evidenca penale nëse i njëjti është më parë i dënuar, dhe varësisht çka rezulton nga ajo, të merret si rrethanë lehtësuese apo rënduese. .

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se është plotësisht i pafajshëm dhe nëse shihet diku në kamera duke i marrë sendet, më dënoni me çfarëdo rrethane rënduese. Ka shtuar se është prind i tre fëmijëve, nuk ka asnjë te keqe me prokurorin e shtetit, pasi që e di se i njëjti e kryen punën e tij.

Provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar pa vërejtje këto prova: Raporti i oficerit i datës 31.08.2020; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B.M. i datës 07.04.2020; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit F.S. i datës 21.10.2020; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit A.G. i datës 05.09.2020; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit D.D. në polici i datës 06.09.2020; Vërtetimi mbi kthimin e sendeve i datës 06.09.2020; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.09.2020; është bërë vështrim në foto dokumentacionin në 7 shtojca, si dhe është bërë vështrim ne te dhënat e personit nga evidenca penale për te pandehurin.

Përpos provave materiale gjykata gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka administruar edhe provat personale.

Gjatë seancës për shqyrtimin gjyqësor dt. 21.05.2024 është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit edhe i dëmtuari B.M. dhe dëshmitari A.G..

Dëshmitari B.M. duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit te shtetit ka deklaruar se nuk e njoh as nuk e kam parë kurrë te pandehurin, se ditën kritike kanë qenë disa gjëra - vegla, te cilat një shok i vëllait te dëshmitarit i quajtur F.S. i cili është në Suedi, lidhur me ato vegla e ka thirrë vëllai, një pjesë që i ka marrë i ka ngarkuar në veturë te tije e një pjesë që nuk ka arrit që ti ngarkojë në veturë i ka lënë te pompa e derivateve , duke i njoftuar punëtorët e pompës që të kujdesen për to derisa të kthehet qe ti marr, për ti marrë ato vegla e ka porositur vëllai dhe kur ka ardhur për ti marrë serish pjesën e mbetur, pasi e ka vërejt se ka gjësende më pak, punëtorët e pompës e kanë njoftuar se ka ardhur një veturë, ngjyrë bronzë, me sa e kujton dhe i ka ngarkuar sendet, dhe punëtorët kanë menduar se është shok i dëshmitarit dhe nuk e kanë penguar që ti ngarkojë ato sende. Ne pyetjen e prokurorit se kur ka filluar me i ngarku këto vegla në automjetin e tije dhe pjesa tjetër kanë mbet jashtë, a je kujdes që ato vegla të mbetura ti lej në përkujdesje, apo keni lënë ndonjë numër, dëshmitari është përgjigjur se ju ka thënë atyre djemve të pompës kqyrni pak qeto sende, dhe ata i kanë thanë ti dole erdh një kerr tjetër i mori. Po ashtu dëshmitari ka treguar se nuk e di sa gjësende kanë qenë por qe ka pasur kutija dhe zmadhues, vegla muzikore, vlerën e tyre nuk e di dhe nuk e di as çka është marrë, sepse ai nuk i ka shiku ashtu në detaje, dhe kur ka ardhur F.S. ai e ka njoftuar dhe ka shkuar në polici, po ashtu e ka njoftuar edhe vëllaun dhe policinë, që mos me dyshu F... se i ka marrë vetë dëshmitari, pasi atë nuk e ka njoft.

Dëshmitari A.G. duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit te shtetit se cili është relacioni me të pandehurin ka deklaruar se punon në gastronomi, dhe se të pandehurin këtu prezent nuk e njeh. Ne pyetjen se a ja ka dhënë automjetin Tauran ngjyrë hiri, këtu të pandehurit D.D., dëshmitari ka deklaruar se nuk e di saktësisht, nuk i kujtohet, sepse ka kaluar kohë e gjatë, por qe ka dhënë deklaratë ne polici dhe se qëndron pranë saj, se te pandehurin nuk e njeh dhe se nuk e ka parë as një here, se automjetin Tauan ngjyrë hiri e ka marrë nga ne rent në Prishtinë, por nuk i kujtohet saktësisht se kush, por se i kanë treguar se ka ndodhur diçka me derë të automjetit dhe ai ka ardhur drejtë në polici dhe i kanë treguar se ka ndodhur një vjedhje, të pandehurin nuk e njoh më herët personalisht, por vetëm tani po më kujtohet se e kam parë në stacion policor **dhe po më kujtohet se i ka kthyer disa sende në stacion policor.**

Në pyetje te te pandehurit se a e ka thirrë dëshmitarin B.V. në telefon dhe a e njeh dëshmitari ka deklaruar se, veturën e ka marrë në shfrytëzim dhe e ka kthy dhe nuk e njoh me emër B.V., ndodh që është diku ndonjë B.V. por nuk e njoh, nuk e di, ndoshta edhe më ka thirr, ndodh që ka qenë ai personi që më ka thirr.

Gjykata ka provuar qe te siguroi prezencën e te dëmtuarit ne këtë çështje penale, por per shkak se i njëjti jeton jashtë vendit ne Suedi, nuk ka qene e mundur sigurimi i prezencës se te njëjtit andaj gjykata ka lexuar deklaratën e ti te dhëne ne polici.

Sa i përket dëshmitarit të propozuar nga i pandehuri, B.V., gjykata ka bërë të gjitha përpjekjet për sigurimin e tij, po ashtu edhe prokurori i shtetit ka bërë përpjekje për sigurimin e ndonjë adrese të dëshmitarit të propozuar por që ka qenë e pamundur, rrjedhimisht gjykata ka revokuar aktvendimin për dëgjimin e këtij dëshmitari pasi që këmbëngulja e të pandehurit që të sigurohet ky dëshmitar sipas bindjes së kësaj gjykate ka qenë me tepër për të zvarritur procesin gjyqësor dhe jo për të vërtetuar ndonjë gjendje faktike të pretenduar nga i pandehuri.

Gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit në seancën e dt. 05.08.2024, i njëjti ka dhënë deklaratime kontraverze të cilat kanë qenë tërësisht në kundërshtim me të gjitha provat e nxjerra gjatë shqyrtimeve gjyqësore, madje edhe pohimeve të mëhershme kur ka deklaruar se gjësendet e vjedhura i ka dorëzuar në polici pasi ka qenë i detyruar nga një person i rrezikshëm me emrin B.V., që për gjykatën këto deklaratime kanë qenë me tepër për të shmangur përgjegjësinë penale, por që nuk ka mohuar se në deklaratën e dhënë në polici, qëndron nënshkrimi i tij.

Në pyetje të gjykatës i pandehuri ka deklaruar se aktualisht është në vuajtje të dënimit për veprë penale të vjedhjes, se a ka edhe vepra tjera penale për të cilat dyshohet apo është i dënuar, i pandehuri ka deklaruar se po është i dënuar edhe për sulm ndaj personit zyrtar dhe akuzohet edhe se e ka therrur një serb me thikë. I pandehuri ka shtuar se tani i janë bërë tre fëmijë dhe këto vepra të gjitha janë vepra të vjetra, që i ka bërë më përpara, është duke i vuajtur dënimet dhe ka për qëllim që ti kthehet jetës normale, të kujdeset për familje për fëmijë, sepse asgjë nuk është duke hequr ai burgjeve, por që është duke vajtuar familja e tij dhe fëmijët.

Në deklaratën e tij dhënë në polici dëshmitari – i dëmtuari F.S. kishte deklaruar se jeton në Suedi dhe se punon së bashku me vëllain e dëshmitarit B.M., dhe se në kohën kur ka ndodhur rasti i ka thënë B... që të del dhe të marrë veglat muzikore pasi që në atë kohë ka qenë me pushime në Shqipëri, ku B... kishte marrë një pjesë të atyre veglave dhe se nuk ka qenë hera e parë që B... kishte dalë dhe kishte marrë sende të dërguara nga i dëmtuari dhe se as të B... dhe as të vëllait i tij nuk ka pasur asnjë herë asnjë dyshim. Tutje i dëmtuari ka dëshmuar se diku shtatëdhjetë për qind e gjësendeve të vjedhura i ishin kthyer nga policia.

I pandehuri nuk e ka mohuar se i ka dorëzuar gjësendet gjegjësisht veglat muzikore në polici por që sipas pretendimeve të të pandehurit kishte qenë i detyruar nga një person i rrezikshëm, gjë të cilën nuk ka arritur ta argumentojë me asgjë, dhe ky deklaratim i të pandehurit bie nënesh me tërësinë e provave të ekzaminuara gjatë shqyrtimeve gjyqësore madje edhe me vet deklaratimet e të pandehurit në fazat e mëhershme të procedurës së zhvilluar kundër tij, por që sipas bindjes së kësaj gjykate, këto pretendime të pandehurit me tepër i ka bërë si tentativë për të shmangur përgjegjësinë penale. Po ashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarit A.G. gjykata ka arritur të bëjë lidhjen kauzale të të pandehurit me përdorimin e automjetit me të cilin ishin vjedhur veglat muzikore nga i pandehuri, të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës së prokurorisë.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Kjo Gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, vërtetohet kjo gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i pandehuri me dashje dhe me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, i merr pasurin e personit tjetër dhe atë veglat muzikore të përshkruara si më sipër.

Për më tepër, i akuzuari vetëm ka mohuar fajësinë por nuk ka paraqitur as një provë të vetme me të cilën do të vërtetohet se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Faktet jokontestuese

Nuk është kontestues fakti se i pandehuri me datë kohë dhe vendin si në dispozitiv të aktakuzës ka shkuar në parkingun e "...", i cili gjendet afër magjistrales në dalje të Vushtrrisë në drejtim të Prishtinës dhe aty ka ngarkuar veglat muzikore të cilat kishin ngelur në përkuqjesje të punëtoreve të pompës së derivateve ku i pandehuri duke shfrytëzuar mirëbesimin e punëtoreve të derivateve të cilët kishin menduar lehtë se i pandehuri po i merr veglat pasi është menduar se është shok i dëshmitarit B.M. por ata nuk kishin qenë në dijeni se në fakt i pandehuri i kishte marrë veglat me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm. Fillimisht ishte identifikuar vetura në të cilën ishin ngarkuar veglat muzikore, tutje ishte vërtetuar se në kohën kur ishin vjedhur këto vegla automjetin e kishte pas në përdorim vet i pandehuri i cili nuk ka mundur ta mohojë se vet i kishte dorëzuar të njëjtat vegla në polici gjë e cila vërtetohet edhe nga vërtetimi mbi kthimin e sendeve i datës 06.09.2020.

Nuk është kontestues as fakti se i pandehuri ka pranuar se i kishte kthyer veglat kurse pretendimi se ka qenë i detyruar nga një person i supozuar i rrezikshëm bie tërësisht ndesh me gjendjen e vërtetuar faktike.

Faktet kontestuese

Kontestues ka qenë fakti se i pandehuri D.D. a e ka kryer veprën penale, vjedhjen për të cilën ngarkohet me aktakuzë.

Gjykata ka vlerësuar dhe shqyrtuar të gjitha provat materiale dhe deklaratat e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka arritur në përfundim se i pandehuri në asnjë moment nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të provonte se nuk ka qenë në posedim të veglave muzikore që nga koha kur ishte konstatuar se të njëjtat po mungonin në parkingun e derivateve ku i kishte lënë dëshmitari B.M..

Në anën tjetër në anën e pandehuri nuk e ka mohuar se është i dënues dhe i dyshues edhe për vepra të tjera të kësaj natyre.

Vlerësimi sipas ligjit i provave nga ana e gjykatës

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat në shkresat e lëndës dhe deklaratat e palëve të dhëna si në polici ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur, ashtu qe deklarimeve të dëshmitarëve, u fali besim të plotë pasi që të njëjtat janë koncize, të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa deklaratave të të pandehurit me të cilat përjashton mundësinë që të ketë pasur ne posedim veglat qe nga fillimi dhe se ato ia kishte dhënë një person i rrezikshëm i supozuar, gjykata nuk u fali besim për shkak se të njëjtat fare nuk kanë qenë bindëse gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nuk janë të bazuara në asnjë provë, bien në kundërshtim me deklaratimet e vetë të pandehurit dhe me provat në shkresat e lëndës, ku përveç deklaratave dhe provave të tjera materiale kjo vërtetohet edhe nga te gjitha provat rrethore te rastit.

Neni 313 par 1 i KPK-së për veprën penale “Vjedhja” parasheh se: “Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.”

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë se dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat, por pa u kufizuar si në dispozitat e nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana renduese gjykata ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale, intensiteti i rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i pandehuri edhe me par ka qenë i dënuar për veprë të njëjtë penale, si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra. Ndërsa sa iu përket rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi por pa u kufizuar ne, kohën e gjatë te kaluar nga koha e kryerjes se veprës penale, moshën relativisht te re te te pandehurit ne kohën e kryerjes se kësaj vepre.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se ky dënim me gjobë dhe burgim është dënim adekuat me shkallen e rrezikshmërisë se veprës penale dhe shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim ndaj tij do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë.

Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPP-së ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi per udhëzimin e palës se demtuar ne kontest civil gjykata e mori ne vështrim te dispozitave te nenit 462 par 2 te KPP-së ku qëndron se “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari

shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.

Nga çka u tha me lartë e ne vështrim të dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 21, 42, 43, 69, 70, dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 364, 449, 452, e 462 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal,
P.nr. 380/21, dt.28.08.2024

Zyrtarja ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga momenti i marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.